

GJYKATA E QARKUT E MITROVICES
P Nr. 61/09
19 Janar 2010

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA E QARKUT E MITROVICES, me Gjyqtare te Gjykimit Hajnalka Veronika Karpati me pjesmarrjen e Tara Khan Keshilltare Ligjore e EULEX-it si procesmbajtse ne rastin kunder;

Lendrit Rizvanollit, i akuzuar sipas Aktakuzes Permbledhese PP. Nr. 40/09 me date/ dhe i paraqitur ne Shkrimoren e Gjykates se Qarkut te Mitrovices ne 18 Gusht 2009, per vepren penale Lendim i Lehte Trupor, ne kundershtim te Nenit 153 Paragrafi (1) Pika 1 lexuar se bashku me Paragrafin (2) te Kodit Penal te Kosoves (KPK)

Pas mbajtjes se séancave publike te Gjykimit Kryesor ne datat 13, 14 dhe 19 Janar 2010, ne pranine e te akuzaurit Lendrit Rizvanolli, avokatit te tij mbroites Zeqir Maxhuni, Prokurorit Nderkombetar Neeta Amin, Pales se Demtuar **B.W.** (me perjashtim te séances se 19 Janarit 2010), Perfaqesuesit te Pales se Demtuar **V.D.**, ne 19 Janar 2010, sipas Nenit 473 Paragrafi (2) i KPPPK-se shpalli publikisht dhe ne prani te te akuzuarit dhe mbrojtetit te tij, Prokurorit te EULEX-it dhe Perfaqesuesit Ligjor te Pales se Demtuar si me poshte kete;

AKTGJYKIM

I akuzuari **Lendrit RIZVANOLLI**, me pseudonim Djordje, djali i Xhevat Rizvanollit dhe Xhylyrije Bajramit, i lindur ne 20 Nentor 1987, ne Gjakove, Kosove, me prejardhje Etnike Shqiptar, vendbanimi i fundit, ne rrugen Sylejam Vokshi, Gjakove, beqar, jeton me prinderit, me shkolle te mesme, anetar i Forcave te Sigurimit te Kosoves me page mujore prej 200 Euro ne muaj, nuk ka kryer vepra te tjera penale

Shpallet

I PAFAJSHEM

-pasi ne 30 Dhjetor 2008 rreth ores 15:30, kur i pandehuri Lendrit Rizvanolli se bashku me shokun e tij **B.W.** kane kaluar Uren kryesore te lumit Ibar ne Mitrovice dhe

kane ecur per ne drejtim te Mitrovices se Veriut, ne kryqezimin e pare pas ures, te semaforet ne rrugen King Peter ne Mitrovicen e Veriut, ata jane rrethuar dhe sulmuar nga nje grup afersisht prej 10 te rinjsh (meshkuj) qe e kane goditur te akuzuarin dhe shokun e tij me grushta dhe shqelma. Ne menyre per te shmangur lendime me serioze dhe per te ciluar veten nga grupi i sulmuesve, i akuzuari ka nxjerre nje thike nga xhepi i brendshem i xhaketes dhe ka bere levizje vertikese me thike, ku ka shkaktuar nje lendim, te natyres se lehte, nje plage prej 11 cm te gjate ne anen e majte te legenit, te B. H. ishte ne grupin e sulmuesve. Ne ate moment anetaret e grupit ndalen se godituri, u zbrapsen pak dhe ne kete menyre i akuzuri dhe shoku i tij i shpetuan grupit dhe u larguan ne drejtim te ures dhe u kthyen perseri ne Mitrovicen e Jugut. i akuzuari veproi ne mbrojtjen e nevojshme.

SI RRJEDHOJE i akuzuari Lendrit Rizvanolli

Lirohet

nga akuza per vepren penale **Lendim i Lehte Trupor**, ne kundershtrim te Nenit 153 Paragrafi (1) Pika 1 lexuar se bashku me Paragrafin(2) te Kodit Penal te Kosoves (KPPPK) sipas Nenit 390 pika1) e KPPPK-se dhe Neni 8 Paragrafi (1) i KPPK-se.

Te gjitha sendet e konfiskuara nga i akuzuari Lendrit Rizvanolli, sic jane listuar ne certifikaten e konfiskimit date 31/12/2008, duhet ti rikthehen te akuzuarit sipas Nenit 117 Paragrafi (3) i KPPPK-se.

Te gjitha sendet e konfiskuara nga B. L. sic jane listuar ne certifikaten e konfiskimit date 31/12/2008, duhet ti kthehen B. L. sipas Nenit 117 Paragrafi (3) i KPPPK-se.

Ne baze te Nenit 103 Paragrafi (1) i KPPPK-se shpenzimet e procedures penale sipas Nenit 99 Paragrafi (2) Nenparagrafi 1 deri ne 5 te KPPPK-se, shpenzimet e nevojshme te te pandehurit pagesa e shpenzimeve te domosdoshme te avokatit mbrojtjes, si dhe shpenzimet e perkthimit duhet te paguhen nga burimet buxhetare.

Kerkesa pronesore e pales se demtuar N. B. referohet per procedure civile sipas Nenit 112 Paragrafi (3) i KPPPK-seCK.

ARSYETIM

A. Historia procedurale

Prokuroria e EULEX-it Neeta Amin paraqiti nje Aktakuze Permbledhese ne Gjykatën e Qarkut te Mitrovices ne 20 Gusht 2009. Seancat e Gjykimit Kryesor jane mbajtur ne 13,14 dhe 19 Janar 2010. Jane degjuar fjalet perfundimtare te Prokurores se EULEX-it Neeta Amin, Perfaqesuesit te pales se demtuar Dejan Vasic, dhe Avokatit Zeqir Maxhuni ne 19 Janar 2010. Aktgjykimi verbal eshte paraqitur po te njejten dite.

B. Kompetencat e Gjykates

Sipas Nenit 21 Paragrafi (1) KPPPK, Gjykatat Komunale jane kompetente per te gjykuar ceshtje qe perfshijne akuza te denueshme me gjobe ose burgim deri ne pese vjet. Sipas Nenit 27 Paragrafi (1) i KPPPK-se, juridiksioni territorial eshte i pershtatshem me gjykatën qe eshte ne territorin ku pretendohet te jete vepra penale.

Sic eshte pershkruar me lart, akuza per lendim te lehte trupor ne shkelje te Nenit 153 Paragrafi (1) pika 1 dhe Paragrafi (2) i KPPPK-se lejon per vendosje te denimit me burg deri ne tre vjet. Per me tej ne aktakuzen permbledhese pretendohet qe i akuzuari te kete kryer vepren penale ne fjale ne Mitrovicen e Veriut.

Si rrejdhoje Gjykata Komunale e Mitrovices eshte organizmi juridik kompetent per te zhvilluar kete procedure penale;

Ne 14 Tetor 2009, Kryetarja e Asamblese se Gjyqtareve te EULEX-it ushtroi te drejten e saj per te caktuar Gjyqtare te EULEX-it ne ceshtjet qe bien nen kompetencat subsidiare te Gjyqtareve te EULEX-it sipas Nenit 3.5 te "Ligjit mbi Juridiksion, Zjedhjes se ceshtjeve, dhe Ndarjen e ceshtjeve Gjyqtareve dhe Prokuroreve te EULEX-it ne Kosove" dhe ja caktoj kete ceshtje Gjyqtareve te EULEX-it te Gjykates se Qarkut te Mitrovices. Kryetare e Trupit Gjykues per kete ceshtje eshte caktuar Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati.

C. Permbledhje e provave te paraqitura

Gjate zhvillimit te Gjykimit Kryesor, jane marre ne pyetje keta deshmitare;

- (1) H.B. - Pale e demtuar, 13 Janar 2010
- (2) B.M. - Deshmitar, 13 Janar 2010
- (3) Selim Binaku - Polic, 13 Janar 2010
- (4) B.U. - Deshmitar, 14 Janar 2010

Gjate zhvillimit te gjykimit kryesor dokumentet e meposhteme kane hyre si prova:

- (5) Raporti i Policise se Kosoves me date 10 Gusht 2009
- (6) Skica e vizatuar ng. B.U. ne 14 Janar 2010
- (7) Fatura e pageses se Universitetit te Prishtines e dates 30 Dhjetor 2009

Ne 14 Janar 2010, per procesverbalin jane lexuar dokumentet e meposhteme

- (8) Certifikate PK-se e sendeve te Konfiskuara nga i akuzuari ne 31 Dhjetor 2008.
- (9) Certifikate PK-se e sendeve te Konfiskuara nga B.U. ne 31 Dhjetor 2008.
- (10) Pese fotografi te thikes se konfiskuar nga i Akuzuari.
- (11) Memorandumi i PK-se per Stacioni i Policise se Veriut nga Hetuesi Ekrem Ahmeti me date 28 Janar 2009.
- (12) Raporti Hetimor i SRK-se (Skuadra Rajonale e Krimet) nga Hetuesi Ekrem Ahmeti me date 13 Janar 2009.
- (13) Raporti Hetimor i SRK-se nga Hetuesi Ekrem Ahmeti me date 16 Janar 2009
- (14) Memorandumi PK-se Stacionit Policor te Veriut nga Rreshter Arbent Plana dhe Hetues Ekrem Ahmeti i dates 28 Janar 2009.
- (15) Dy raporte hetimore te SKR-se nga Hetuesi Ekrem Ahmeti, te dy me date 31 Dhjetor 2008.
- (16) Raporti i PK-se nga Nebojsa Milic date 30 Dhjetor 2008 ne oren 20:00
- (17) Raporti i PK-se nga Mirko Jovanovic date 30 Dhjetor 2008 ne oren 18:25.
- (18) Raporti i PK-se nga Shemsi Istrefi date 30 Dhjetor 2008 ne oren 16:15.
- (19) Raporti i PK-se nga Nebojsa Milic date 30 Dhjetor 2008 ne oren 21:00.
- (20) Kerkesa per analizat e thikes se konfiskuar nga i akuzuari.
- (21) Formulari i zinxhirit te ruajtjes/mbajtjes lidhur me thiken e konfiskuar.
- (22) Kerkese per egzaminim provash ne laboratorin kriminalistik te dates 09 Janar 2009 lidhur me nese eshte gjetur gjak ne thiken e konfiskuar.
- (23) Urdher Gjykate te analizat e ADN -se ne thiken e konfiskuar.
- (24) Urdher i Prokurorise per analizat e ADN -se se mostres se gjakut te N.B. date 27 Tetor 2009.
- (25) Rezultat i analizave te ADN -se ne thiken e konfiskuar date 10 Nentor 2009.
- (26) Raporti Mjektor i B.U. date 30 Dhjetor 2008.
- (27) Raporti Mjektor i te akuzuarit date 30 Dhjetor 2008.

Gjate seances se gjykimit kryesor ne 14 Janar 2010 i akuzuari dha deklarate dhe ju pergjigj pyetjeve.

D. Vleresimi i provave te paraqitura

1. Konstatimet faktike

Mbi provat e paraqitura gjate gjykimit te kryesor, gjykata konsideron faktet e meposhteme si te provuara:

Ne mengjesin e dates 30 Dhjetor 2009, i akuzuari bleu nje thike ne Prishtine. Me pas rreth ores 11:00, ai u takua me shokun e tij B.U. . Ata kryen disa porosi se bashku dhe pastaj shkuan per te ngrene. Ndersa po hanin i akuzuari ra dakort te shoqeronte B.U. ne Mitrovicen e Jugut per te takuar personalisht nje vajze me te cilen B.U. kishte biseduar online. Ata moren nje kombi/minibus nga Prishtina per ne Mitrovicen e Jugut. Ndersa ishin ne kombi ne oren 14:00 B.U. dergoi nje tekst SMS vajzes ne fjale per ti treguar qe

ai po vinte ne Mitrovicen e Jugut me nje shok. Ai gjithashtu u perpoq te kontaktonte ate nga celulari i tij.

Ende nuk kishte patur pergjigje nga vajza ne kohen kur i akuzuari dhe B.U. zbriten nga autobuzi ne Mitrovicen e Jugut. B.U. u perpoq ta kontaktonte ate nga celulari i te akuzuarit. Me pas ata pastaj ecen nga posta me Mitrovicen e Jugut duke u perpjekur per ti telefonuar asaj perseri. Meqenese B.U. nuk mund ta kontaktonte ate ata shkuan te kafeneja prane postes ku ata qendruan per rreth nje ore duke folur. Me pas ata dolen per te ecur dhe pane Uren Kryesore, qe ishte prane kafenese.

I akuzuari dhe B.U. pa qe ishin disa persona duke ecur ne ure, dhe qe policet dhe ushtaret e KFOR-it jane stacionuar ne ure. Per shkak se gjendja dukej e mire ata vendosen te ecnin neper Ure per te pare Mitrovicen e Veriut. Ata kaluan uren dhe ecen perafersisht 100 metra neper Mitrovicen e Veriut ne Rrugen King Peter ndersa po flisnin me njeri-tjetrin Shqip. Ne ate moment dikush i thirri ata nga pas, ne Serbisht. Ata u kthyen per te pare se kush i thirri dhe pane qe ishin te rrethuar nga rreth dhjete djem dhe te rinj te ethnicitetit Serb. Mashkulli Serb qe ishte perpara te akuzuarit pyeti ne Serbisht "Odakle ste?", por i akuzuari dhe B.U. thjesht pane njeri -tjetrin pasi asnje prej te dyve nuk fliste Serbisht. Ai person pastaj i guajti te akuzuarit ne anen e majte te fytyres dhe anetaret e tjere te grupit filluan ti godasin dhe ti guajne me shqelma. Te dy i akuzuari dhe B.U. ngriten duart lart per te mbrojtur fytyrat e tyre dhe rane ne gjunje ne toke ndersa goditeshin vazhdimisht.

Goditjet vazhduan per 3-4 minuta kur i akuzuari u kutjua qe kishte me vete thiken e re. Ai futi doren ne xhepin e brendeshem te xhaketes se tij dhe nxori thiken, e nxori nga kellefi dhe filloi ta levizte ne menyre kercenuese sa nga njera ane ne tjetren qe te mbrohej nga sulmi. Gjate kohes qe po levizte thiken sa nga njera ane ne tjetren ai ndjeu qe thika preku nje person ne grup kur goditi me thike palen e demtuar N. B. ne te majte te pjeses se poshtme te kurrizit. i akuzuari pastaj u kthye mbrapa me thike qe t'ja tregonte sulmuesve qe ishin prapa tij, dhe pastaj u kthye perseri. Si rezultat i kesaj sulmuesit ndaluan dhe u zbrapsen ne nje distanca te vogel.

I akuzuari dhe B.U. e perdoren kete mundesi per ti shpetuar grupit. B.U. filloi te vraponte ne fillim drejt ures kryesore dhe thirri te akuzuarin qe menjehere vrapoi pas tij. i akuzuari filloi te vraponte me thiken ende ne doren e djathte, te future brenda xhepit te djathte te tutave te tij te sportit. Ata vune re qe anetaret e grupit po i ndiqnin ata dhe po i gjuanin me gure. Kur i akuzuari arriti te ura dhe u ndje me i sigurte, ndersa ende duke vrapuar futi thiken ne kellefin e saj dhe e futi perseri ne xhep. Ne anen jugore te ures, ata u derozuan te PK te stacionuar atje. Polici e kontrolloi te akuzuarin dhe i konfiskoi thiken. Ata i cuan ne stacionin e policise se jugut ku B.U. ra te fiket dhe u desh ta sillnin ne vete. Me pas ata i cuan ne Qendren Shendetesore te Mitrovices ku u mjekuan per lendimet e shkaktuara.

Si rezultat i sulmit i akuzuari kishte pesuar lendime ne duart e tij, ne gjoks dhe ne abdomen. B.U. pesoi gjithashtu tronditje ne tru si dhe lendime ne fytyre, qafe dhe duar.

Si rezultat i goditjes me thike pala e demtuar N.B. pesoi nje lendim te natyres carje (nga goditja me thike) prej rreth 11 cm ne *gluteus*-in te tij te majte (muskulin e majte te vitheve).

2. Provat qe Percaktojne Konstatimet Faktike

Konstatimet faktike te pershkruara me lart jane provuar nga deklaratat e metejshme dhe provat dokumentuese.

I akuzuari deklaroi qe ne mengjesin e 30 Dhjetorit 2008 ai po ecte ne lagjen Peyton te Prishtines kur pa nje tezge ku shiteshin thika, kuleta dhe sende te tjera. Ai bleu nje thike per ta patur ne eskursionet me kembe dhe peshkim edhe pse ishte e lire.

Te dy i **Akuzuari** dhe deshmitari B.L. deshmuane ne menyre te qendrueshme si me poshte:

I akuzuari dhe i takuan ne Prishtine ne 30 Dhjetor 2008 rreth ores 11:00, ku ata kryen disa porosi se bashku te universiteti dhe shkuan per te ngrene. Ndersa po hanin B.L. e bindi te akuzuarin qe te shkonte me te ne Mitrovicen e Jugut qe te takoheshin me nje vajze me te cilen ai kishte komunikuar permes internetit. Ata hypen ne nje kombi dhe ndersa ishin ne autobuz B.L. i dergoj nje mesazh me telefon vajzes ku e informonte ate qe ata po vinin ne Mitrovice. B.L. gjithshu u perpoq ti telefononte vajzes nga te dy celularet, nga telefoni i tij dhe i te akuzuarit.

Nga regjistrimi mates i mesazheve te derguara nga telefoni i B.L. del qe teksti eshte derguar ne 30 Dhjetor 2008 ne oren 14:00.¹ **Regjistrimet matese** te telefonatave te bera nga celularet e B.L. dhe te te akuzuarit tregojne se te dy telefonatat jane bere nga telefoni i B.L. te ai i vajzes ne oren 13:56 dhe 14:00,² dhe dy telefonata jane bere nga celulari i te akuzuarit ne oren 14:49 dhe 15:00.³

Kur i akuzuari dhe B.L. zbriten nga kombi ne Mitrovicen e Jugut, ata shkuan ne poste per ti telefuar perseri vajzes, por ne telefon pergjigjej nje mashkull. Per kete arsye ata vendosen per te shkuar ne nje kafene aty afer ku ata qendruan per rreth nje ore dhe pastaj dolen te ecin. Ata ju afruan Ures Kryesore, qe ishte shume afer me kafenene dhe pane qe kishte shume njerez qe ecnin nga njera ane ne tjetren te ures. Ata gjithashtu pane PK dhe ushtare te KFOR-it te pozicionuar ne Ure dhe B.L. propozoi qe at ate kalonin uren per te pare Mitrovicen e Veriut. Ne fillim i akuzuari ishte i pasigurt por eventualisht ra dakort. i akuzuari nuk kishte qene ndonjehere me pare ne Mitrovicen e Veriut me pare. Ata ecen neper ure per ne Mitrovicen e Veriut dhe vazhduan te ecin duke folur me njeri-tjetrin Shqip me nje ton normal te zerit.

¹ Dosja e prokurorise f. 184 (Anglisht)

² Dosja e prokurorise f 193 (Anglisht)

³ Dosja e prokurorise f 183 (Anglisht)

Video eurvejimit tek Ura Kryesore tregon te Akuzuarin dhe B.U. duke kaluar uren per ne pjesen Veriore ne oren 15:31.⁴

ndersa po flisnin me njeri-tjetrin Shqip. Ne ate moment dikush i thirri ata nga pas, ne Serbisht. Ata u kthyen per te pare se kush i thirri dhe pane qe ishin te rrethuar nga rreth dhjete djem dhe te rinj te etnicitetit Serb. Mashkulli Serb qe ishte perpara te akuzuarit pyeti ne Serbisht “Odakle ste?”, por i akuzuari dhe B.U. thjesht pane njeri –tjetrin pasi asnje prej te dyve nuk fliste Serbisht, ne menyre qe demonstronte qe ata nuk kuptonin. Pastaj i akuzuari tha m’fal ne Shqip kur po ai person qe i foli pastaj i gjuajti te akuzuarit ne anen e majte te fytyres. Anetaret e tjere te grupit filluan menjehere ti godasin dhe ti guajne me shqelma te dyve te akuzuarit dhe B.U. Te dy i akuzuari dhe B.U. ngriten duart lart per te mbrojtur fytyrat e tyre dhe rane ne gjunje ne toke ndersa goditeshin vazhdimisht.

Ata nuk kishin mundesi te largoheshin dhe goditjet vazhduan per rreth 3-4 minuta.

Gjykata beson se grupi perbehej nga rreth dhjete persona, nje perzierje meshkujsh te rinj rreth 20 vjec. Ne deklaraten e tij perpara prokurores se EULEX-it, i akuzuari deklaroi qe anetaret e grupit ishin te pakten “mbi 25 vjecare” me trupa te beshem.⁵ Gjate deklarates se tij ai shtoi “ e di qe ne ate grup disa prej tyre ishin me te rinj por ata ishin shume. Nuk mund te shihja se kush ishte i ri e kush ishte me i vjeter. E di qe atje kishte persona te rinj gjithashtu.”⁶ Ai rikujtoi qe personi qe e goditi i pari ne fytyre ishte me i gjate se ai dhe “jo i ri ne moshe.”⁷ **Deshmitari** B.U. perafersisht llogariti qe ata ishin dhjete persona ne ate grup, disa te gjate dhe disa te shkurter dhe qe ishin me shume se sa 20 vjec. Atij nuk i kujtohet te kete patur femije apo djem te rinj, “ai nuk pati mundesi te shihte pasi kjo ndodhi brenda nje sekonde”⁸ dhe ai ishte shume i traumatizuar nga goditjet e fuqishme qe kishte marre nga sulmi i menjehershme dhe goditjet me grushta dhe shqelma pa fund, si dhe gjithashtu per faktin qe i akuzuari dhe B.U. kishin mbuluar fytyrat me duar per mbrojtje dhe si rrjedhoje e kishin te penguar pamjen, asnjeri nuk e kishte mundesine te veshgonte sejcilin anetar te grupit. Si rrjedhoje eshte realiste dhe e kuptueshme qe ata nuk kane vene re me ne vecanti moshat dhe pershkrimet fizike te gjithe personave/individene grup. Per me tej polici Mirko Jovanovic raportoi se ai pa 5-10 persona te ndiqnin te akuzuarin pas per ne Uren Kryesore, dhe se keta persona ishin ne pjesen me te madhe te rinj.⁹

Gjykata me tej beson se ka patur persona te tjere qe nuk ishin pjese e “grupit sulmues” fillestar, por se ishin ne afersi te menjehershme me vendin e ngjarjes dhe ne nje menyre apo tjetër ishin pjese e grupit te personave te pergjithshem. Kjo shpejgohet ne detaje te metejshme me poshte.

⁴ Raporti i akuzave penale i dates 30 Dhjetor 2008 by Ekrem Ahmeti, Dosja e prokurorise f. 256 (Anglisht)

⁵ Procesverbali i seances se marrjes ne pyetje te te dyshuarit, 21 Korrik 2009, Dosja e prokurorise f. 26 (Anglisht).

⁶ Procesverbali i Gjykimit Kryesor, 14 Janar 2010, f. 22 (Anglisht)

⁷ Procesverbali i Gjykimit Kryesor, 14 Janar 2010, f. 22 (Anglisht)

⁸ Procesverbali i Gjykimit Kryesor, 14 Janar 2010, f. 13 (Anglisht)

⁹ Raporti Policor nga Mirko Jovanovic i dates 30 Dhjetor 2008, Dosja e Prokurorise f. 246 (Anglisht)

Rrahjet vazhduan per rreth 3-4 minuta ndersa i akuzuari dhe B.D.nuk ishin ne gjendje te largoheshin por vetem te strukeshin duke mbuluar kokat e tyre per tu mbrojtur. Sipas videove survejuese ne ure shihen dy figura qe policia beson teb jene i akuzuari dhe B.D. duke kaluar uren ne oren 15:31 per ne Veri, dhe po keta duke vrapuar te kthehen mbrapsht ne Jug ne oren 15:36.¹⁰ Meqenese perleshja filloi pothuajse menjehere pasi ata hyne ne Mitrovicen e Veriut diku rreth 100 metra nga ura, atehere i akuzuari dhe B.D. jane goditur dhe shkelmuar gjate pjeses dermuee te ketyre pese minutave qe kaluan.

I akuzuari dha nje shpjegim te detajuar te asaj qe ndodhi me pas. Ndersa po vazhdonin goditjet, ai mban mend qe thika qe kishte blere me heret ishte ende ne xhepin e brendshem te xhaketes se tij. Ndersa me doren e tij te majte kishte mbuluar koken per tu mbrojtur me doren e djathte ai hapi zinxhirin e xhaketes dhe futi doren ne xhepin e brendshem qe ishte i hapur dhe kapi thiken qe ishte me tehun poshte dhe brenda kellefit. Ai e nxori thiken, e nxori nga kellefi dhe filloi ta levizte nga njera ane ne tjetren qellimi i tij nuk ishte per te lenduar dike, por per te mbrojtur veten, pasi ai "u perpoqa te lendoja dike sa me pak te ishte e mundur, vetem qe te dilja prej aty"¹¹ Gjate levizjes gjysem rrotulluese me thike (kur po levizte thiken sa nga njera ane ne tjetren/per kercenim) ai beri kontakt me dike qe ishte duke qendruar prane tij, nuk e di se kush. Personi i goditur me thike u zbraps menjehere. i akuzuari pa qe ai kishte floke me ngjyre te erret, dhe kishte veshur xhakete te zeze dhe po qendronte me duart te vena ne anen e majte te legenit/vitheve, por nuk i kujtohet fytyra e personit te lenduar. i akuzuari u kthye te tregonte qe kishte thike te te tjeret qe ishin ne grupin rrethues qe po e sulmonin nga pas, dhe u kthye menjehere mbrapsht. i tere grupi u terhoq, duke e zgjeruar keshtu rrethin rreth te akuzuarit dhe B.D. i akuzuari pa B.D. qe filloi te vraponte gjate ketij momenti pauze dhe i thirri atij " largohu" dhe i akuzuari filloi te vraponte gjithashtu.

Deshmitari B.D.nuk e ka pare ne momentin qe i akuzuari nxori thiken dhe beri levizjet kercenuese me te e as qe ka pare kur i akuzuari ka goditur me thike nje person te grupit. Sidoqofte ai mbeshtet deklaraten e te akuzuarit ne sa thuhet me poshte: **Deshmitari B.D.** deklaroi qe kur mbaroi perleshja ai pa qe i akuzuari kishte ne dore nje thike. Ne kete moment B.D. dhe i akuzuari ishin 2-3 metra larg njeri-tjetrit dhe anetari i grupit me afer me te akuzuarin ishte 20-30 cm larg. Deshmitari B.D. e pa personin qe ishte goditur me thike nga i akuzuari qe mbante duart ne vithet, sidoqofte ai nuk mund ta pershkruaje ate person pasi ai ishte fokusuar se si te shpetonte. Ata ende ishin te rrethuar por anetaret e grupit u terhoqen ne nje distance nga B.D. dhe i akuzuari per shkak te thikes, keshtu qe ata e shfrytezuan kete mundesi dhe filluan te vrapojne drejt ures.

Deklaratat e Pales te Demtuar N. B. dhe Deshmitar B. M. gjithashtu mbeshtesin disa aspekte te perleshjes dhe te goditjes me thike, sidoqofte keto deklarata do te diskutohen ne detaje me poshte.

I akuzuari dha deklarate te detajuar sa i perket se si ata jane larguar nga vendi i ngjarjes. Kur ai se pari filloi te vraponte me shume shpejtesi, ai ende kishte thiken ne doren e tij te

¹⁰Raporti i akuzave penale te dates 30 Dhjetor 2008 nga Ekrem Ahmeti, Dosja e Prokurorise f. 256 (Anglisht)

¹¹ Procesverballi Gjykimit Kryesor, 14 Janar 2010, f. 22 (Anglisht)

djathte dhe kellefin ne doren e majte. Dora e tij e djathte po mbante te huen e thikes, qe ai kishte vene me doreze - poshte brenda xhepit te djathte te tutave te sportit. Ai nuk vuri re gjak ne thike, por ndjeu qe tehu ishte i lagur, ndoshta me yndyre/dhjam trupor. Ai po vraponte pak me mbrapa deshmitarit B.U. Ai vuri re qe po i ndiqnin disa njerez si dhe qe i gjuanin me gure. Kur ju afrua ures dhe ndjeu qe ishte jashte rrezikut, ai ngadalesoi ritmin futi thiken ne kellef dhe e futi perseri ne xhep. Ata vrapuan neper ure tek dy Policet e PK-se te stacionuar ne anen jugore.

Deshmitar B.U. ka deshmuar qe po vraponte nje ose dy metra perpara te akuzuarit. Per kete arsye, ai nuk mund ti shihte levizjet egzakte te te akuzuarit ne lihje me thiken dhe kellefin e saj. Ai pa mbrapa dy ose tre here ndersa po vraponte, dhe pa anetare te grupit qe i ndiqnin ata dhe qe gjuanin me gure. Ai nuk vuri re femije qe qendronin atje si kalimtare dhe askush nuk i kishte bllokuar rrugen ndersa ai vraponte per tek ura. Sa kaluan uren, ata u dorezuan tek PK te stacionuar ne anen jugore te ures.

Raportet e policise tregojne qe i akuzuari dhe B.U. vrapuan nga rruga King Peter ne anen veriore ndersa po ndiqeshin nga 5-10 te rinj kaluan uren dhe u dorezuan tek PK ne anen jugore rreth ores 15:36.¹² i akuzuari u kontrollua nga PK dhe ju konfiskua thika prej tyre.¹³

Kjo mbeshtetet gjithashtu nga deklarata e **PK-se Selim Binaku**. Polici Binaku ishte ne uren kryesore ne kohen kur i akuzuari dhe B.U. arriten perseri ne ure, duke vrapuar drejt Mitrovices se Jugut pas perleshjes. Ai deklaroi qe po ecte drejt vetures se Policise se Kosoves e parkuar ne anen jugore te ures ne menyre qe te merrte dorezat qe ishin brenda ndermjet ores 15:30 dhe 15:45 kur vuri re dy persona te rinj qe vraponin neper ure e te cilet u ndalen te Policet e stacionuar atje. Pasi i mori dorezat, ai i pa keta persona duke folur me policin nga nje distance perafersisht 5-10 metra prej nga ai qendronte. Me vone ai u udhezua ti sillte djemte ne stacionin e policise se Jugut.

Ne ate kohe, polici Binaku vuri re qe te dy djemte ishin te lenduar ne fytyre, te dy i kishin duart e fryra dhe B.U. po i dilte gjak nga ana e majte e hundes. Ai pa qe te dy ishin psikologjikisht te shqetesuar dhe po dridheshin. Ne dhomen e intervistes ne stacionin e policise B.U. humbi ndjenjat, dhe u desh qe ai te permendej me uje. Prokurori Publik arriti ne stacionin e policise ne oren 18:45 dhe urdheroi qe te dy te dergoheshin ne Qendren Shendetesore te Mitrovices.¹⁴ Si rezultat i sulmit i akuzuari pesoi nje shembje/ndrydhje ne doren e tij te djathte, shembje ne gjoks dhe ne zonen abdominale.¹⁵

¹² Raporti i oficerit Mirko Jovanovic date 30 Dhjetor 2008, dosja e prokurorise f. 246 (Anglisht); Raporti i oficerit Darko Damljanovic date 30 Dhjetor 2008, Dosja e Prokurorise f. 248 (Anglisht); Raporti i akuzave penale date 30 Dhjetor 2008 nga Ekrem Ahmeti, Dosja e Prokurorise f. 256 (Anglisht); Raporti i Hetuesit nga Ekrem Ahmeti date 16 Janar 2009, Dosja e Prokurorise f. 232 (Anglisht).

¹³ Raporti i Oficerit by Darko Damljanovic date 30 Dhjetor 2008, Dosja e Prokurorise f. 248 (Anglisht); Raporti i Oficerit nga Shemsi Istrefi date 30 Dhjetor 2008 ne 16:15, Dosja e Prokurorise f. 250.

¹⁴ Mbeshtetur nga raporti i Hetuesit, date 31 Dhjetor 2008, Dosja e Prokurorise f. 238 (Anglisht).

¹⁵ Raportet Mjeksore 30 Dhjetor 2008, Dosja e Prokurorise f. 212 (Anglisht).

B.U. pesoi nje tronditje ne tru/koke, nje tronditje ne vertebren cervikale/te qafes dhe te perziera.¹⁶

3. Deklarata e Pales se Demtuar

Ne kohen e incidentit, **Pala e Demtuar** N. B. ishte 15 vjec. Ai ishte 17-te vjec kur ka deshmuar perpara Gjykate. Ai deklaroi qe ne 30 Dhjetor 2008 rreth ores 15:30 ai po shkonte ne kembe nga shkolla ne shtepi me shokun e tij B. M. . Ata po ecnin ne rrugen e tyre te zakonshme, Rruga King Peter. Kur ata ju afruan dyqanit te mishit Smigic, ata kaluan prane 5-6 te rinj te moshes 19-20 qe po bisedonin. Rreth 2-3 metra pasi i kishin kaluar ata, N. B. . degjoi nje "zhurme" pas tij dhe kuptoi qe pas tij kishte plasur nje perleshje. B.M. . u kthye pas te shihte se cfare po ndodhte dhe ndersa N. B. . po kthehej te shihte gjithashtu ai ndjeu goditje me thike ne anen e majte poshte kurrizit nga nje mashkull qe kishte vene kapele me ngjyra. Ai nuk e pa mire personin qe e goditi dhe nuk e pa thiken. Ai menjehere ra ne toke, dhe duke rene ai pa personin qe e goditi me thike qe vraponte drejt ures kryesore. Atij nuk i kujtohet asgje me tutje.

Sic deklaroi, pala e demtuar nuk pa ndonje perleshje apo sulm –ai vetem degjoi nje zhurme dhe me pas ai ishte goditur me thike perpara se sa te kthehej plotesisht mbrapa e te shikonte- ai nuk mund te afroje gjyktes ndonje ndihmese ne percaktimin e gjendjes faktike.

Per me tej, mosperputhjet ndermjet deklarates se tij perpara Gjykates dhe deklaratave te meparshme perpara policise se Kosoves ne 05 Janar 2008 dhe Prokurorit Publik ne 03 Gusht 2009 e vene ne dyshim deshmine e tij. Ne fjalen e saj perfundimtare Prokurorja Publike paraqet qe pala e demtuar ka qene i qendrueshem ne deklaratat e tij si ne polici ashtu dhe perpara prokurorise dhe Gjykates. Sidoqofte Gjykata nuk bie dakort. Ne te dy deklaratat e meparshme pala e demtuar theksoi se e ka pare perleshjen dhe se nmje person u largua nga grupi, duke vrapuar drejt tij dhe e goditi me thike. Ne 03 Gusht 2009, ai vecoi se ai u kthye mbrapa per te pare perleshjen dhe se pa nje njeri qe po perpiqej te largohej nga grupi; qe e pa kete njeri te largohej duke vrapuar drejt tij.¹⁷ Kur eshte konfrontuar me keto kontradikta ne gjykate, pala e demtuar theksoi se ai ishte i frikesuar kur ishte marre ne pyetje nga policia, dhe nuk e kishte pare perleshjen, vetem kishte degjuar zhurme dhe supozoi se kishte perleshje.

Gjykata pranon se disa mosperputhje ndermjet deshmise dhe deklaratave te meparshme munt ti ngarkohen moshes se re te pales se demtuar dhe eksperiences se frikshme te marrjes se lendimit nga goditjame thike. Sidoqofte nese ky shpjegim pranohet ne teresi, gjykata mbetet ne kete rast vetem me deshmine e pales se demtuar perpara Gjykates qe si thuhet dhe me lart ofron shume pak detaje qartesuese ne percaktimin e fakteve qe te cojne ke goditja me thike.

Sidoqofte Gjykata nuk pranon qe pala e demtuar nuk e ka pare perleshjen. Nuk eshte realiste qe nje djale adoleshent si ne kete rast pala e demtuar nuk do kishte degjuar

¹⁶ Raportet Mjeksore 30 Dhjetor 2008, Dosja e Prokurorise f. 210 (Anglisht).

¹⁷ Raport i Egzaminimit te Pales se Demtuar, 03 Gusht 2009, f. 3 (Anglisht).

zhurmen e perleshjes qe po ndoshte prane tij, nje perleshje qe zgjati afersisht 3-4 minuta, dhe te mos kthehej per te pare se cfare po ndodhte. Per me tej duke konsideruar konstatimet e gjykates ne kete incident ka patur vetem nje goditje me thike (qe shpjegohet ne detaje me poshte), eshte me llogjike dhe ne perputhje me natyren njerezore qe pala e demtuar jo vetem veshtroi per te pare se cpo ndodhte, por u afrua mjaftueshem ne perleshje per tu lenduar nga i akuzuari kur ani nxori thiken.

4. Deklarata e Deshmitarit B.M.

Ka patur nje sere mos perputhjesh ndermejt deklarates se deshmitarit B.M. perpara Gjykates ne 13 Janar 2010 dhe deklarates se tij te meparshme te bere ne policine e Kosoves dhe ne Prokurori.

Deshmitari B.M. : deshmoi se ndersa po ecte per ne shtepi nga shkolla me palen e demtuar ne rrugen King Peter ne 30 Dhjetor 2008, ata kaluan nje grup prej rreth pese persona te rinj ne rruge mbi moshen 20 vjec dhe me trupa mesatare. Ata gjithashtu kaluan prane dy te rinjve. Kur kaluan Mishtoren Smigic, ai degjoi "nje zhurme" nga pas dhe u kthye per te pare. Ai pa "nje perleshje" dhe pa dy te rinj duke vrapuar nga grupi drejt tyre. Ai degjoi dike nga grupi duke bertitur "Ata jane Shqiptare!" dhe "Keni kujdes ata kane thike"! Ai nuk pa asnje nga grupi qe te ndiqte dy personat qe po vraponin. the group towards them. He heard someone from the group yell out "They are Albanianai ap njerin prej djemve qe u larguan te nxirrte nje thike me te cilen goditi palen e demtuar ne kurriz. Pala e demtuar ra ne toke dhe Deshmitari B.M. i ngriti doren makines se pare qe pa dhe e coi ate ne spital.

Ne deklaraten e tij ne polici ne 16 Maj 2009, B.M. deklaroi se kur ai dhe pala e demtuar N.B. degjuan zhurme ndersa po kalonin tek Mishtorja Smigic, ata u kthyen per te pare se cfare po ndodhte. Ai pa nje perleshje ndermjet perafersisht 5 personave qe zgjati per pak minuta. Papritur dy nga djemte dolen nga grupi dhe filluan te vrapojne. Djemte e tjere bertiten "Keni kujdes, ata jane Shqiptare!" dhe i ndoqen ata B.M. pa qe njeri prej djemve qe vrapuan kishte thike ne doredhe ai dhe pala e demtuar u perpoqen te shkonin per te shpetuar pas makines por pala e demtuar u godit ne kurriz me thike.

Deklarata e deshmitarit B.M. perpara prokurorit publik ne 03 Gusht 2009 eshte teresisht e qendrueshme me deklaratat e tij ne polici, dhe shton te dhenat e meposhteme te rendesishme lidhur me perleshjen dhe goditjen me thike:

Ndersa po kalonte Mishtoren Smigic, ai degjoi zhurme dhe degjoi qe dy djem te rinj i kishin ndalur disa djem me te medhej i ne moshe diku pese metra me larg.

- Ai pa dy Shqiptare dhe diku rreth tre Serbe.
- Se pari Serbet dhe Shqiptaret po bisedonin me njeri -tjetrin, dhe me pas ai pa nje nga Serbet qe e goditi njerin prej Shqiptareve me grusht. Kjo ndodhi perafersisht 5-7 metra larg nga B.M.

- Ai degjoi te bertitura “Keta jane Shqiptare, keta jane Shqiptare.”
- Ai pa nje perleshje qe filloi qe vazhdoi rreth dy minuta.
- Te dy Shqiptaret dolen me vrap nga perleshja, dhe ai qe u goditi i pari nxori nje thike.
- Ai pa thiken ne doren e Shqiptarit.
- Ai degjoi te bertiste “Keni kujdes, ai ka nje thike!”
- Ai dhe pala e demtuar u perpoqen te shpetonin por nuk i nxuri vendi ndermjet dy makinave ku donin te hynin. Pastaj Shqiptari me thike goditi me kete palen e demtuar.
- Ai nuk e pa Shqiptarin me thike te kete goditur dike nga grupi i perleshjes me thike.

Deshmitari B.M. eshte marre ne pyetje ne detaj rreth kontradiktave ndermjet deklaratave te tij dhe deshmise se tij. Shpjegimi i tij i pergjithshem per pagendrushmerite ishte qe ai i ka bazuar deklaratat e tij te meparshme ne cfare ai supozoi dhe besoi dhe jo ne cfare ai ne fakt ka pare personalisht. Kur eshte marre ne pyetje dhe nje here nga gjykata nese ai ka pare ndonje perleshje, B.M. u pergjigj “Asgje ne vecanti, por une supozova se kjo ishte cfare po ndodhte.”¹⁸ Kur pyeti perseri nese ai pa nje nga Serbet ne grup te godiste njerin prej Shqiptareve, ai u pergjigj “Jo, une pashe perleshje por asgje specifike.”¹⁹ Sidoqofte, ai konfirmoi se ai e pa te akuzuarin te nxirrte thiken dhe te godiste me thike palen e demtuar.

Gjykata e konstatoi te pamjaftueshem shpjegimin e deshmitarit lidhur me mos qendrushmerite ne deklaratat e tij. Nese gjate deklarates ne polici dhe perpara prokurorise ai thjesht supozonte qe kjo perleshje kishte ndodhur dhe nuk i kujtohej se cfare kishte pare ne fakt, nuk eshte as e llogjikshme e as e besueshme qe ai do jape nje shpjegim te ketyre detajeve –per shembull, qe sulmi filloi me nje goditje ndaj njerit prej Shqiptareve dhe zgjati per disa minuta – perpara se Shqiptaret te largoheshin. Ne vecanti e demshme per besueshmerine e deklarates se deshmitarit eshte pyetja nese ai e ka pare goditjen e pare ndaj te akuzuarit qe ne fakt filloi dhe perleshjen. Deklarata e tij e meparshme perpara prokurores eshte precise – ai e pa goditjen. Prokurorja me pas beri pyetje te metejshme qe konfirmuan se ai pa me pas te njejtin Shqiptar qe u goditi te nxirrte thiken.²⁰ Ne pergjigjet e tij nuk ka mungese qartesis apo konfuzitet. Gjithashtu nuk ka interpretim tjetër/ndryshe te arsyeshem te pergjigjeve te deshmitarit. Sidoqofte perpara gjykates, B.M. tentoi te riformuloje deklaratat e meparshme te tij, duke pretenduar qe ai ne asnje moment nuk pa njerin prej Shqiptareve te goditej dhe “goditja” ju referua ai deklarates ishte kur pala e demtuar goditi me thike.²¹ Ky shpjegim i ri i goditjes eshte edhe konfuz edhe i pabesueshem.

Eshte opinioni i Gjykates qe B.M. ka perjetuar perleshjen ne teresi dhe ka dhene deklarata te sakta ne Policine e Kosoves dhe perpara Prokurores Publike, por me vone eshte perpjekur ti zbehe dimensionet e asaj, qe ai perjetoi, gjate deshmise se tij. Per me tej deklaratat e meparshme te B.M. plotesisht mbeshtetin deklaratat e te akuzuarit

¹⁸ Procesverbali I Gjykimit Kryesor, 13 Janar 2010, f. 18 (Anglisht).

¹⁹ Procesverbali I Gjykimit Kryesor, 13 Janar 2010, f. 18 (Anglisht).

²⁰ Procesverbal I egzaminimit te deshmitarit 03 Gusht 2009, f. 4 (Anglisht).

²¹ Procesverbali I Gjykimit Kryesor, 13 Janar 2010, f. 20 (Anglisht).

dhe deshmitarit B.M. me nje perjashtim te vetem, ate te momentit kur ka ndodhur goditja me thike e pales se demtuar. (kjo ceshtje diskutohet ne detaje me poshte.) per keto arsye Gjykata konstatoi se deklarata e deshmitarit B.M. gjate Gjykimit Kryesor nuk eshte e besueshme.

5. Incidenti Njejes i Goditjes me thike

Gjykata ka degjuar dy versione te ndryshme te ngjarjes se goditjes me thike- nje nga i akuzuari dhe deshmitari B.U. dhe nje nga pala e demtuar dhe deshmitari B.M. Ne versionin e pare i akuzuari nxori thiken gjate luftimit ne menyre qe ti shpetonte grupit. Ne kohen qe e conte thiken me nga njera ane ne tjetren me levizje te harkuar ai ndjeu qe kishte foditur dike me thike. Ishte ky veprim qe beri qe te pushonte sulmi dhe sulmuesit te zbrapseshin, duke i dhene keshtu mundesine te akuzuarit dhe deshmitarit B.U. qe te largoheshin. Ne versionin e dyte te ngjarjeve, i akuzuari se pari nxori thiken qe ti shpetonte grupit. Dhe pastaj sic po largohet nga grupi, per te shpetuar veten, ai e nxori thiken per here te dyte dhe ndersa po kalonte prane dy kalimtareve gjate rruges per tek ura goditi me thike palen e demtuar B.S.

Gjykata konstatoi se pas diskutimeve te zjarra te dates 30 Dhjetor 2008, ka patur vetem nje incident te goditjes e thike te kryer nga i akuzuari.

Se pari per arsyet tashme te diskutuara, deklaratat e te akuzuarit dhe te deshmitarit B.U. jane te besueshme, ndersa deklarata e pales se demtuar jep shume pak informacion dhe deklarata e deshmitarit B.M. nuk eshte e besueshme. i akuzuari pranoi se ai ka goditur nje person me thike ndersa po e levizte nga njera ane ne tjetren ne menyre te harkuar per te ndalur sulmin dhe per tu larguar. Ai deklaroi se nuk e ka nxjerre thiken ne asnje moment tjetet deri sa arriti ne Uren Kryesore.

Se dyti versioni i paraqitur nga pala e demtuar dhe deshmitari B.M. jo vetem qe permban kontradikta, por ne te njejten kohe eshte shume jo realist. Eshte e padiskutueshme qe i akuzuari dhe shoku i tij deshmitari B.U. jane sulmuar nga nje grup te rinjsh Serbe (rreth 10 persona), ne Mitrovicen e veriut ate dite. Sulmi qartesisht eshte bere pasi ata ishin Shqiptare; ata nuk kuptuan kur ju eshte folur Serbisht, ata specifikisht u pyeten se prej nga vinin por ata nuk mund te pergjigjeshin ne Serbisht. Pastaj gjate sulmit dikush bertiti "ata jane Shqiptare" ne nje shtuate te tille eshte absolutisht jo realiste dhe e palogjikshme qe kur dy Shqiptaret mundet te shpetonin nga nje sulm prej disa minutash, ku njeri prej tyre kercenoi me thike dhe ndersa po vraponin ne drejtim te ures per ne Mitrovicen e Jugut ndersa po ndiqeshin ng. disa anetare te grupit sulmues, qe i akuzuari do te humbiste kohe te nixirte thiken perse ri dhe te godiste me thike nje person te pafajshem jashte grupit.

Keshtu qe sic theksohet ne dispozitivin e mesiperem, gjykata konstatoi se ne menyre qe te shmange lendime te metejshme dhe per ti shpetuar sulmit i akuzuari nxori thiken nga xhepi i brendshem i xhaketes se tij dhe beri levizje kercenuese, duke levizur thiken nga njera ane ne tjetren ndersa ende ishte i rrethuar nga grupi. Ishte ne kete moment qe ai

shkaktoi nje lendim te natyres se lehte ne anen e majte te pejses se legenit te *N.B.* qe ishte ne grupin e sulmuesve.

Gjykata i referohet Pales se Demtuar duke qendruar “ne grupin e sulmuesve”, per te mos thene qe pala e demtuar ishte, vete, njeri prej sulmuesve. Nese pala e demtuar ishte ndermjet sulmuesve nuk u percaktua pertej dyshimit te bazuar, e as qe mund te perjashtohet. Roli i tij i sakte nuk mund te percaktohet. Gjykata konstaton vetem qe ne momentin kur pala e demtuar ishte goditur me thike, ai po qendronte *shume prane vendit te ngjarjes, nje krah distance* nga i akuzuari –afër mjaft per tu lenuar kur i akuzuari u perpoq te shpetonte veten nga grupi – dhe keshtu mund te thuhet qe ai ishte ndermjet personave ne ate grup te pergjithshem ne vendin e ngjarjes; te sulmit.

E. Kualifikimet ligjore

1. Ligji i Aplikuar

Vepra ne fjale sipas akuzes penale eshte kryer ne 30 Dhjetor 2008. Ne ate kohe Kodi i Perkohshem Penal i Kosoves, qe ka hyre ne fuqi ne 06 Prill 2004, ka qene ligji aplikues. Sipas Nenit 2 Paragrafi (1) i Kodit te Perkohshem Penal, ligji ne fuqi ne kohen e kryerjes se vepres penale duhet te aplikohet ndaj kryesit. Nuk ka patur ndryshime ne ligj perpara ketij aktgjykimi, qe do te ishin favorizuese per te akuzuarin sipas Nenit 2 Paragrafi (2) i KPPK-se.

Edhe pse Aktakuza e ka ngarkuar te akuzuarin sipas Kodit Penal te Kosoves qe hyri ne fuqi ne 06 Janar 2009, Nenet relevante jane identike ne te dy Kodet. Per kete arsye Gjykata i eshte referuar te dy dispozitave te KPPK-se si ligji aplikues ne kohen e kryerjes se vepres penale.

Ne aktgjykim dhe gjate tere gjykimit Gjykata ju referua dispozitave relevante te Kodit te Procedures Penale te Kosoves per shkak te rrethanave te vecanta ne Mitrovicen e Veriut. Dispozitat e KPPK-se jane plotesisht identike me dispozitat e Kodit te Procedures Penale te Kosoves.

2. Mbrojtja e nevojshme

Eshte e qarte dhe e padiskutueshme qe i akuzuari ka shkaktuar lendime te lehta trupore pales se demtuar duke goditur me thike. Sidoqofte gjykata konstaton se ky veprim ishte nje pergjigje direkte dhe proporcionale ndaj nje sulmi te paligjshem, real, te vazhdueshem ndaj tij dhe shokut te tij nga i cili ai po perpiqej te shpetonte.

Sipas Nenit 8 te KPPK-se nje veprim i kryer ne mbrojtje te nevojshme nuk eshte veper penale “kur nje person kryen veprim per te shmangur nje sulm te shpejte real te paligjshem, ndaj vetes apo nje personi tjetër dhe natyra e vepres eshte proporcionale me shkallen e rrezikut te paraqitur nga sulmi” keshtu ne kete ceshtje kemi dy pika per te konsideruar; se pari; nese i akuzuari ka vepruar *per te shmangur nje sulm te shpejte real*

te paligjshem ndaj vetes dhe ndaj shokut te tij Blerim Uka, dhe se dyti nese pergjigja ishte *proporcionale* me sulmin.

Faktet rreth fillimit te sulmit nga grupi i meshkujve Serbe te panjohur ndaj te akuzuarit dhe B.U. nuk jane te diskutueshme. Ishte nje sulm i pa ligjshem i nisur mbi baza te etnicitetit te tyre Shqiptar dhe per faktin qe ata po ecnin ne Mitrovicen e Veriut. Nga deklaratat dhe raportet mjeksore eshte e qarte se ky sulm ishte real/ i vertete dhe i rendesishem. Te dy ishin te tejkaluar ne numer dhe moren goditje te vazhdueshme qe rezultonin ne lendime te dukshme qe jane pare nga polici Binaku. B.U. ka humbur vetedijen kur ishte ne Stacionin e Policise ne Jug dhe egzaminimi mjeksor konfirmoj qe ai kishte marre nje tronditje ne tru si rezultat i goditjeve te forta ne koke. Sulmi kishte vazhduar per disa minuta ndersa i akuzuari dhe B.U. nuk kishin mundur te largoheshin. Ndersa ishte bere kruspull dhe po mbante duart per te mbrojtur koken, i akuzuari kishte nxjerre thiken per tu vetembrojtur.

Meqense i akuzuari perdori thiken kunder goditjeve dhe shkelmimeve, gjykates i eshte dashur te egzaminoje nese ai ka vepruar proporcionalisht lidhur me shkallen e rrezikut te paraqitur nga sulmi.

Gjykata konstatoi se duke marre ne konsiderate natyren e sulmit te paraqitur si dhe menyren se si i akuzuari e ka perdorur thiken, i akuzuari ka vepruar proporcionalisht me shkallen e rrezikut te paraqitur. i akuzuari dhe B.U. nuk jane sulmuar vetem nga nje ose dy, tre persona por nga nje grup perafersisht prej 10 djemsh te rinj. Sulmi ka perfshire goditje, grushta qe kane qene te nje fuqie te tille qe kane shkaktuar tronditje ne tru. Sulmi ka vazhduar per disa minuta dhe ne nje distance te afert. Ne nje suate te tille, e vetmja menyre qe i akuzuari gjeti per te nderprere sulmin ishte te paraqiste thiken. Duke vepruar keshtu, ai deklaroi qe qellimi i tij ishte te shkaktonte sa me pak lendime qe te ishte e mundur- thjesht te mundesonte largimin e tij nga sulmi. Si pasoje e ketyre veprimeve, roli egzakt i te cilit ne kete rrethane nuk mund te percaktohej, pesoi nje lendim te lehte te prerjes me thike. i akuzuari nuk tentoi te shkaktonte lendime te metejshme apo te perdorte thiken per hakmarrje, por menjehere u largua prej sulmuesve.

Sipas ligjit nje veprim i kryer ne mbrojtje te nevojshme nuk eshte veper penale. Si rrjedhoje i akuzuari duhet te lirohet.

F. Sendet e konfiskuara

Si pasoje e shfajesimit/lirimit, sendet e konfiskuara nga i akuzuari Lendrit Rizvanolli dhe nga Deshmitari B.U. duhet te kthehen sipas Nenit 117 Paragrafi (3) of the KPPPK-se.

G. Shpenzimet

I akuzuari shpallet i pafajshem, si rrjedhoje ai nuk eshte i detyruar te rimbursoje shpenzimet e procedures penale, sipas Nenit 103 Paragrafi (1) i KPPPK-se. Shpenzimet e procedures penale nen Nenin 99 Paragrafi (2) Nenparagrafi (1) deri ne (5) i KPPPK-se, shpenzimet e nevojshme te pandehurit dhe pagesa e shpenzimeve te nevojshme te avokatit mbrojtës, si dhe shpenzimet e perkthimeve me goje dhe shkrim duhet te paguhen nga burimet buxhetore.

H. Kërkesa per Kompensim

Gjate Gjykimit Kryesor, ne seancen e 13 Janarit 2010, Pala e Demtuar **N. B.** paraqiti kerkese pronesore me Gjykatën e Qarkut, sipas Nenit 109 te KPPPK-se. pasi i akuzuari shpallet i pafajshem, kerkesa pronesore e pales se demtuar duhet te referohet per procedure civile, sipas Nenit 112 Paragrafi (3) i KPPPK-se.

Gjykata e Qarkut e Mitrovices P. nr. 61/2009

E pergatitur ne Anglisht, gjuhe e autorizuar

Procesmbajtese

Kryetare e Trupit Gjykues

Tara Khan

Hajnalka Veronika Karpati

Keshille ligjore:

Personat e autorizuar mund te dorezojne ankese me shkrim kunder ketij aktgjykimi permes Gjykates Komunale te Mitrovices ne kolegjin me tre anetare te Gjykates se Qarkut te Mitrovices brenda tete ditesh nga dita kur aktgjykimi eshte dorezuar, sipas Nenit 473 Paragrafi (3) i KPPPK-se.